



THIRRJE PER APLIKIM PËR STUDIME TREGU DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, AMA, në përmbushje të objektivave, funksioneve dhe kompetencave sipas ligjit organik 97/2013, shpall këtë thirrje për aplikim për institucione dhe organizata, të cilat punojnë dhe kontribuojnë në fushën e medias.

Subjektet e interesuara ftohen që brenda **datës 25.04.2016, ora 16.30** të paraqesin dorazi në zyrën e protokollit të Autoritetit projekt-ide sipas një prej aspekteve të mëposhtme:

-studim tregu mbi ndikimin e inovacionit teknologjik në sjelljen e aktorëve, ofertave përmbajtësore në peisazhin audioviziv dhe atë mediatik në përgjithësi;

-studim tregu mbi sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë sfidave të online-zimit të shërbimeve audiovizive;

-organizim trajnimesh me gazetarët e medias audiovizive në qarqet kryesore të vendit, për raportimin sa më të drejtë, të saktë dhe të ndjeshëm të tematikës që lidhet me fëmijët, me barazinë gjinore dhe në përmirësimin e performancës nga aplikimi i teknologjive të reja dhe internetit.

Aplikimi që dorëzohet në zyrën e protokollit të AMA-s brenda afatit duhet të përfshijë emërtimin e institucionit/organizatës, duke paraqitur përmbledhtazi aktivitetin; përshkrimin e përgjithshëm të projektidesë, objektivat, produktet dhe eventet që do të realizohen, afatet brenda datës 31 dhjetor 2016 dhe buxheti i parashikuar; kontakti i aplikuesit, adresa postale dhe online; personi me të cilin do të komunikohet, emaili dhe telefoni.

AMA do të vijojë komunikimin vetëm me aplikuesit të cilëve ju vlerësohet projektideja si në përputhje me kërkesat e kësaj thirrjeje.

Autoriteti i Mediave Audiovizive

25 Mars 2016